



RAPORTI I - V - | PËR MUAJIN QERSHOR 2010

MONITORUESI I KORRUPSIONIT

Raporti i Monitorimit mbi Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë Kundër Korrupsionit

“... deri në shtator të vitit 2011 Kosova do të ketë një qeveri të pastër nga korrupsioni, një drejtësi ku kanë qasje të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë dhe një sektor privat pa ndërhyrje politike...”

PËRMBAJTJA

Përmbledhje.....	4
Hyrje.....	5
Qeveria e Kosovës.....	6
Kuvendi i Kosovës.....	8
Sistemi Gjyqësor.....	10
Prokuroria e Shtetit.....	10
Këshilli Gjyqësor i Kosovës.....	10
Agjencia Kundër Korrupsionit.....	11
Doganat e Kosovës.....	12
Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.....	12
Policia e Kosovës.....	12
Raportet ndërkombëtare/të jashtme.....	14
Raportet nga Shoqëria Civile.....	14
Lëvizja FOL.....	14
Instituti Demokratik i Kosovës.....	15
Falënderime.....	15
Rreth Lëvizjes “FOL”.....	16

LISTA E AKRONIMEVE

AAK – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

AKK – Agjencia Kundër Korrupsionit

AKR – Aleanca Kosovare e Re

DHKEK – Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit

EULEX – Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

IKS – Iniciativa Kosovare për Stabilitet

ISC – Institute for Sustainable Communities (Instituti për Komunitete të Qëndrueshme)

KDI – Kosovo Democratic Institute (Instituti Demokratik i Kosovës)

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

LDD – Lidhja Demokratike e Dardanisë

MASHT – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

MM – Memorandum Mirëkuptimi

PDK – Partia Demokratike e Kosovës

PK – Policia e Kosovës

UNMIK – United Nations Mission Interim in Kosovo (Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë)

ZAP – Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

PËRMBLEDHJE

1. Për periudhën Prill-Qershor 2010 në Gjyqësorin e Kosovës në kuadër të kategorisë “Shpërdorimi i Pozitës Zyrtare ose Autorizimit” nga 119 lëndë gjithsej për këtë kategori janë zgjidhur 10 dhe mbeten 109 lëndë të pazgjidhura. Sa i përket dhënies dhe marrjes së Ryshfetit nga gjithsej 38 lëndë, vetëm 3 nga këto janë të zgjidhura.
2. Policia në anën tjetër ka raportuar se 19 persona gjithsej janë arrestuar për periudhën Janar-Qershor 2010 për vepra të ndryshme të korrupsionit. Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës 68 raste të Korrupsionit janë të dërguara në Prokurori me raport të Prokurorit.
3. Kuvendi i Kosovës gjatë muajit qershor ka mbajtur katër seanca plenare. Gjatë këtyre seancave nuk është vërejtur ndonjë angazhim për të trajtuar aferat e korrupsionit ose për kërkim të llogarisë për angazhimin e qeverisë në luftimin e korrupsionit
4. Në kuadër të sistemit gjyqësor është bërë riemërimi i 76 gjyqtarëve dhe prokurorëve. Janë realizuar edhe disa takime të Kryeprokurorit dhe është premtuar reformë e thellë e sistemit gjyqësor. Edhe KGJK-ja ka publikuar Raportin e II – tre mujor (prill-qershor) në lidhje me rastet korruptive;
5. Angazhimet kryesore të Agjencisë Kundër Korrupsionit kanë qenë në shumë drejtime. Në fillim të qershorit ka përmbyllur suksesshëm procesin e deklarimit të pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë publikë. Gjatë muajit qershor AKK-ja ka nënshkruar po ashtu Memorandumin e Mirëkuptimit me Prokurorinë e Shtetit, me Administratën Tatimore të Kosovës dhe me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm. Gjithashtu ka vazhduar me ritmin e pranimit të informacioneve në lidhje me afera të ndryshme korruptive;
6. Policia e Kosovës ka arrestuar gjashtë zyrtarë në qytetin e Ferizajt, Prishtinës dhe Pejës, nën dyshimin për shpërdorim të pozitës zyrtare, marrje të ryshfetit dhe mashtrim. Ka publikuar po ashtu edhe Raportin gjashtë mujor (janar-qershor) të rasteve që ndërlidhen me shpërdorim të detyrës zyrtare, marrje të ryshfetit dhe dhënie të ryshfetit;
7. Gjatë muajit qershor janë publikuar 4 Raporte: Raporti i Freedom House, Raporti i Paralajmërimit të Hershëm i UNDP-së, Raporti i Iniciativës Kosovare për Stabilitet dhe ai EULEX-it. Këto Raporte shquhen për zërin tejet kritik dhe të drejtpërdrejt për autoritetet vendore të cilat janë të thirrura për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar
8. Lëvizja FOL ka organizuar një tryezë të rrumbullakët për “Luftën ndaj korrupsionit: Progresi dhe Koordinimi Ndër-Institucional” dhe ka publikuar Raportin e Indeksit të Transparencës. Edhe Instituti Demokratik i Kosovës ka publikuar, në një tryezë të rrumbullakët me aktorë relevantë, dobësitë e kornizës e Ligjit për Deklarimin, Kontrollin dhe Prejardhjen e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publikë.
9. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka publikuar Raportin e saj Vjetor për të gjitha ministrinë, komunat, ndërmarrjet publike, agjensionet dhe institucionet e tjera.
10. Niveli i lartë i korrupsionit dhe krimin të organizuar në institucionet publike ka alarmuar edhe deputetët e Bundestagu-t gjerman. Disa nga ata kanë pohuar që “paratë e qytetarëve gjermanë po investohen në vila private të politikanëve kosovarë...ndaj edhe duhet një kujdes ma i shtuar i qeverisë gjermane për të kontrolluar mjetet financiare të taksapaguesve gjermanë sesi shfrytëzohen nga institucionet e Kosovës.
11. Shqetësimi kryesor i qytetarëve të Kosovës, sipas Raportit të Paralajmërimit të Hershëm të UNDP-së, është korrupsioni dhe mungesa e rezultateve në këtë luftë po shkaktojnë edhe një trend të rënies së besueshmërisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

HYRJE

Korrupsioni, i vlerësuar si sfida kryesore për shoqërinë e Kosovës përgjatë 11 viteve të transicionit, vazhdon të mbetet shqetësim i përbashkët i të gjithëve: politikanëve, shoqërisë civile e mediave. Ndërkombëtarët adresojnë këtë çështje në raportet/vlerësimet e tyre të përvitshme dhe qëndrimet deklarative. Bashkimi Evropian me Raportet e Progresit, e Departamenti Amerikan i Shtetit me raportet periodike për çështje të veçanta, mbesin vërejtjet publike që Kosova i merr pothuajse rregullisht viteve të fundit. Ndërsa raportet e organizatave jo qeveritare ndërkombëtare për Kosovën, kanë qenë të vazhdueshme dhe shpesh herë më të ashpra në adresimin e korrupsionit.

Vendasit mbeten të ndarë në qasjen për korrupsionin dhe luftën kundër tij. Përderisa pushtetarët zotohen për 'zero tolerancë korrupsionit dhe krimin të organizuar', opozita adreson të kundërtën, duke e cilësuar 'qeverinë – koka e korrupsionit'. Qëndrimet e tyre për çështjen në fjalë ndryshojnë me ndërrimin e pushtetit, e bashkë me të edhe rolet e tyre. Përgjatë qeverisjes nën administrimin e UNMIK-ut, dhe pas shpalljes së pavarësisë, publiku kosovar në rolin e spektatorit ka mundur të përcjell rokadën e pushtetit dhe retorikën pothuajse boshe për luftën kundër korrupsionit. Çështja e statusit, e më pas bërja e shtetit, janë shndërruar Atutë kryesore pas të cilave politikanët kosovarë janë fshehur vazhdimisht.

Dy vite pas shpalljes së pavarësisë, raportimet investiguese të medieve për korrupsionin, instalimi i Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit, EULEX, dhe forcimi i thirrjeve të shoqërisë civile, kanë prioritetizuar 'luftën kundër korrupsionit'. Edhe pse arrestimi i 'peshqve të mëdhenj' është zëvendësuar me të vegjlit, madje në nivel komunal, pritjet që ndërkombëtarët dhe Kryeministri Thaçi kanë krijuar

për qytetarët, do ta shoqëroj edhe për një kohë politikën ditore në Kosovë.

Lëvizja FOL vazhdon monitorimin e aktiviteteve të institucioneve publike në luftën kundër korrupsionit. Në periodikun e pestë me radhë, për muajin qershor, nuk është shënuar ndonjë aktivitet i Qeverisë apo Kuvendit të Kosovës. E tëra që mund të evidentohet gjatë këtij muaji është arrestimi i disa zyrtarëve në nivel komunal, deklarimi i pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë publikë, nënshkrimi i disa memorandumeve të bashkëpunimit dhe publikimi i disa Raporteve nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare.

QEVERIA E KOSOVËS

Qeveria e Kosovës ka përsëritur edhe në muajin qershor zotimin e saj se do të udhëheq në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar. Ndonëse ky përkushtim i zyrtarëve të lartë shtetërorë është shprehur në vazhdimësi, mungojnë rezultatet e kënaqshme. Shoqëria Civile ka kërkuar në vazhdimësi nga Kryeministri i vendit që të kërkojë dorëheqjen ose të bëjë shkarkimin e zyrtarëve qeveritar që po hetohen për korrupsion. Në këtë kuptim, nëse analizojmë periudhën paraprake, përkatësisht muajt e mëparshëm, rezulton që muaji qershor ka qenë muaji më i zbehtë i aktiviteteve qeveritare në kuadrin e sferës anti-korrupsion. Shefi i Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian, Renzo Daviddi, ka potencuar se lufta ndaj korrupsionit është në duart e vendorëve¹ dhe aferat korruptive po e dëmtojnë imazhin e Kosovës përpara qytetarëve të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe po e dëmtojnë njashtu procesin e

¹ Renzo DAVIDDI, KTV – Edicioni i Lajmeve (19:00), 15 qershor, 2010

MONITORUESI I KORRUPSIONIT

integritit të Kosovës në BE.² Niveli i lartë i korrupsionit dhe krimit të organizuar në institucionet publike ka alarmuar edhe deputetët e Bundestagu-t gjerman. Disa nga ata kanë pohuar që “paratë e qytetarëve gjermanë po investohen në vila private të politikanëve kosovarë...ndaj edhe duhet një kujdes ma i shtuar i qeverisë gjermane për të kontrolluar mjetet financiare të taksapaguesve gjermanë sesi shfrytëzohen nga institucionet e Kosovës.³ Ky mos-veprim i Qeverisë është bërë njëherazi edhe shkak i kritikave dhe akuzave të shumta të partive opozitare. Sipas AAK-së, gjegjësisht liderit të saj Ramush Haradinaj, Qeveria Thaçi është shndërruar në kancer të Kosovës, nga i cili qytetarët janë të rrezikuar sikurse nga rriqrat⁴. Edhe AKR-ja, nëpërmjet një deklarate për shtyp, ka vlerësuar se institucionet qeverisëse në Kosovë kanë dëshmuar se luftën kundër korrupsionit e kanë vetëm retorikë.⁵ Të njëjtin qëndrim mbanë edhe LDD-ja. Sipa saj në Kosovë për më shumë se dy vjet pushteti ka ndërtuar retorikë kundër korrupsionit dhe kundër krimit ekonomik. Në këtë retorikë, sipas LDD-së, është përfshirë edhe EULEX-i, pasi që mungojnë rezultatet konkrete nga ana e tij.⁶ Reagimet e tilla opozitare e kanë shtyrë Kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, që të deklarojë se procesi i luftës kundër korrupsionit në Kosovë është politizuar

shumë dhe është vepruar shumë pak.⁷ Megjithatë, Kryeministri Thaçi ka përsëritur gatishmërinë e tij për luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të cilën do ta udhëheqin institucionet vendore, ndërkaq EULEX-i do të ketë vetëm rol mbështetës. Megjithëse ky është një qëllim i drejtë, realiteti në teren tregon një fotografi tjetër. Prokuroria e Kosovës ende nuk është e kompletuar dhe Kosova ende duhet të nxjerr Ligjin për Prokurori dhe atë për Gjykata. Kryeministri i vendit ka thënë se Republika e Kosovës ka ndërtuar kapacitetet e duhura profesionale, institucionale dhe ligjore, si dhe ka vullnetin politik e guximin që ta luftojë korrupsionin, krimin e organizuar. Kryeministri Thaçi ka thënë se Qeveria e tij do të hetojë të gjitha aferat korruptive dhe të krimit të organizuar që kanë ndodhur nga qershori 1999 e deri me tani. Sipas tij janë 111 raste të dyshimit për hetime të zyrtarëve të institucioneve të Kosovës, duke përfshirë të gjitha qeveritë e pas-luftës, dhe ka premtuar se nuk do të mbetet asnjë rast pa u hetuar.⁸

Shqetësimi kryesor i qytetarëve të Kosovës, sipas Raportit të Paralajmërimit të Hershëm të UNDP-së, është korrupsioni dhe mungesa e rezultateve në këtë luftë po shkaktojnë edhe një trend të rënies së besueshmërisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Ndërkaq përgjegjëse për një gjendje të zymtë socio-ekonomike dhe politike qytetarët e mbajnë Qeverinë e Kosovës (80% e qytetarëve) dhe jo si më parë UNMIK-un apo EULEX-in.⁹ Në të njëjtën linjë të mendimit është edhe Raporti i fundit i Freedom House, i cili pohon që lufta ndaj korrupsionit nuk ka

² Renzo DAVIDDI: Korrupsioni po e dëmton procesin e integritit të Kosovës në BE, Koha Ditore, 11 qershor, 2010, fq. 6

³ Florian HAHN, Botuar në Koha Ditore: Deputetët gjermanë akuzojnë Qeverinë e Kosovës për krim dhe korrupsion, 11 qershor, 2010, fq. 4

⁴ Ramush HARADINAJ: “Është interes i vendit që të shkojë qeveria Thaci, Koha Ditore, 3 qershor, 2010, fq. 7

⁵ Komunikata për shtyp e Aleancës Kosova e Re, 8 qershor, 2010

⁶ Lulzim ZENELI: Banalizimi i luftës kundër korrupsionit, gazeta Ekspress, 24 qershor, 2010, fq. 6

⁷ Jakup KRASNIQI: Korrupsioni është politizuar shumë, Kosova Sot, 14 qershor, 2010, fq. 3

⁸ Hashim THACI: Hetime për të gjitha krimet, Ekspress, 6 qershor, 2010, fq. 5

⁹ Raporti i Paralajmërimit të Hershëm, UNDP Kosovë, 27 mars, 2010, fq. 3-5

shënuar rritje që nga viti 2008, por shkalla e pandryshueshme vazhdon të mbetet 5.75¹⁰

Sipas Raportit të Iniciativës Kosovare për Stabilitet (IKS), në vitin 2009 rreth 35% të respondentëve mendonin se ka korrupsion në qeveri, mirëpo vetëm 11% prej tyre kanë thënë se e kishin përjetuar korrupsionin.

Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit në Kosovë, EULEX ka deklaruar se ka hartuar një plan operativ për hetimet që po i bën në rastet e dyshuara për korrupsion dhe krim të organizuar. Sipas kryeprokurorit të EULEX-it, Johannes van Vreesëijk, deri në shtator të vitit 2011 Kosova do të ketë një qeveri të pastër nga korrupsioni, një drejtësi ku kanë qasje të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë dhe një sektor privat pa ndërhyrje politike.¹¹

Më tutje ka theksuar se ndikimi i politikës në drejtësinë kosovare ka shënuar rënie dhe sipas tij lista e personave që janë nën hetime është shumë e gjatë, në të cilën përfshihen hetimet në gjithë Kosovën, përfshirë edhe Mitrovicën Veriore.¹² Edhe Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian për Kosovën, Peter Feith, ka deklaruar se është koha e duhur për luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, edhe për rastet ku dyshohet të jenë përfshirë udhëheqësit politikë dhe raste të profilit të lartë. Këto raste, sipas tij, duhet të kryhen para mbajtjes së zgjedhjeve të ardhshme (2011).¹³ Më

¹⁰ Ilir Deda: Kombet në Transit 2010 (Kosovë), Raporti i Freedom House, fq. 1. Ky vlerësim me notën 5.75 është jashtëzakonisht i dobët, ngase nota më e dobët (me nivel më vogël të progresit) është 7.0.

¹¹ Johannes van VREESËIJK: EULEX-i me plan për pastrimin e qeverisjes nga korrupsioni, Koha Ditore, 30 qershor, 2010, fq. 1

¹² Johannes van VREESËIJK: Rezultatet e hetimeve të EULEX-it në mars 2010, Kosova Sot, 30 qershor, 2010, fq. 2

¹³ Deklarimi i Feith në Debatin për Kosovën në Parlamentin Evropian, 22 qershor, 2010

tutje Feith ka deklaruar që është në traditën e demokracisë që të hetuarit apo të akuzuarit të japin dorëheqje¹⁴, ndërkaq kjo pikëpamje është hedhur poshtë nga Qeveria e Kosovës, sipas të cilës mendimi i shprehur i z. Feith nuk përfaqëson qëndrimin zyrtar të Brukselit.¹⁵ Për të intensifikuar përpjekjet në luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, EULEX-i do të shtrijë operacionet e tij edhe në Veriun e Kosovës, por pritet në muajt në vazhdim nëse do të ngjanë një zotim i tillë i këtij Misioni. Ne mendojmë që ky shqetësim i qytetarëve të Kosovës për korrupsionin duhet patjetër të ndikojë në një transformim cilësor të qeverisjes në vend duke e vendosur luftën ndaj korrupsionit në krye-agjendën e të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës".¹⁶

KUVENDI I KOSOVËS

Kuvendi i Kosovës gjatë muajit qershor ka mbajtur vetëm katër seanca plenare. Gjatë këtyre seancave nuk është vërejtur ndonjë përkushtim i spikatur nga ana e deputetëve për të diskutuar për aferat korruptive. Janë miratuar disa ligje dhe janë ngritur kryesisht shqetësime që kanë të bëjnë me çështjet makro-politike: sovraniteti, integriteti territorial, festimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe negociatat me Serbinë. Megjithatë, nëse krahasojmë të katër seancat rezultojnë që në seancën e 10 qershorit 2010 është diskutuar me tepër për korrupsionin dhe krimin e organizuar. Deputetët e pavarur¹⁷ janë

¹⁴ Peter FEITH: Në demokraci të hetuarit japin dorëheqje, Koha Ditore, 16 qershor, 2010, fq. 4

¹⁵ Memli KRASNIQI: Opinionet e Feithit për korrupsionin nuk janë të Brukselit, Koha Ditore, 24 qershor, 2010, fq. 5

¹⁶ Hasan PRETENI - Edicioni i Lajmeve (19:30), RTK, 6 qershor, 2010

¹⁷ Gjatë kohës së pyetjeve parlamentare më të zëshmit vazhdojnë të jenë Naim RRUSTEMI dhe Driton TALLI, por edhe deputetë tjerë nga partitë opozitare (AAK, AKR dhe LDD)

treguar më aktivë në denoncimin e aferave të mundshme korruptive, por është evidentuar edhe një spektër më i gjerë i deputetëve që kanë ngritur shqetësimet e tyre për abuzimin e parasë publike nga ana e Qeverisë së Kosovës. Deputeti Naim Rrustemaj ka ngritur shqetësimin për udhëzimin administrativ¹⁸ të Qeverisë së Kosovës. Ky udhëzim, sipas tij, është në kundërshtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik, gjegjësisht me nenin 24 të këtij ligji. Ndërkaq zv. Kryeministri Kuçi ka arsytuar nxjerrjen e këtij vendimi duke pohuar se do të rrisë përgjegjësinë e institucioneve përballë qytetarëve të vendit. Edhe deputeti tjetër i pavarur, Driton Tali, ka ripërsëritur pyetjen për pajisjen e shkollave me teknologji informative që është dhënë 24 milionë më shtrenjtë nga ana e MASHT-it. Mirëpo, mungesa e pranisë së ministrave, e veçanërisht ajo e Ministrisë të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, është duke e ngulfatur dhe, në njëfarë mënyre, duke e pamundësuar funksionimin e nenit 26 të Rregullores së Re të Kuvendit¹⁹ – që krijon hapësirë solide për deputetët e interesuar që të parashirojnë pyetje parlamentare në adresë të kabinetit qeveritar. Deputeti Tali ka adresuar edhe pyetje të shumta në adresë të Kryeministrit në lidhje me procesin e riformatizimit të Qeverisë së tij, madje duke e ironizuar tërësisht këtë proces.

Me një gjuhë më të ashpër dhe kritike është shprehur edhe deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini. Qeveria e Kosovës, sipas tij, është zhytur në korrupsion dhe në pamundësi për ta luftuar atë ka lansuar propagandën e vet se “të gjithë politikanët e Kosovës janë të korruptuar,

¹⁸ Ky udhëzim rregullon mënyrën e nënshkrimit të tenderëve, që për çdo tender, shuma e të cilit kalon mbi 9 mijë euro, duhet të nënshkruhet nga tre zyrtarë, përfshirë edhe vet Ministrin

¹⁹ Neni 26 i Rregullores së Kuvendit të Kosovës, miratuar me 20 Maj 2005, e ndryshuar dhe e plotësuar me 1 Qershor 2006.

kështu që s’ka nevojë të vijë në pushtet ndonjë parti tjetër, sepse edhe ajo është e korruptuar, ose nëse s’është, do të korruptohet edhe ajo”.

Megjithatë, pas miratimit të tre ligjeve (Ligji Anti-korrupsion, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Ligji për Deklarimin, Kontrollin dhe Prejardhjen e Pasurisë së Zyrtarëve Publike), shihet se Kuvendi është pasivizuar në kontekstin e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit. Ky pasivizim në ndërmarrjen e aktiviteteve dhe veprimeve të cilat do të kontrollin Qeverinë ka ndikuar që niveli i kënaqshmërisë së qytetarëve me punën e Kuvendit të pësoi rënie në 33%.²⁰ Kjo përqindje tregon një krizë të thellë legjitimiteti dhe besueshmërie në Legjislativin e vendit – i vetmi organ i zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët e Kosovës.

Sipas deputetit Naim Rrustemi, Kuvendi nuk është i dizajnuar për të luftuar korrupsionin dhe për të kontrolluar qeverinë, sepse fokusi i vetëm i tij është miratimi i ligjeve.²¹ Qëndrim të ngjashëm ka shpërfaqur edhe deputeti i PDK-së, Ramdan Avdiaj, sipas të cilit Kuvendi nuk ka mekanizëm për luftimin e korrupsionit.²² Së fundmi është propozuar që të themelohen edhe komisione për hetime parlamentare të cilat do të mund të shërbenin për iniciimin e hetimeve nga organet e prokurorisë. Nënkrjetari i AAK-së, Ahmet Isufi, ka shprehur bindjen se komisionet hetimore parlamentare përmes punës së tyre do të mund ta ndihmonin në masë të konsiderueshme zbardhjen e keqpërdorimeve që bëhen jo vetëm në Qeveri, por

²⁰ Raporti i Parlajmërimit të Hershëm, UNDP Kosovë, 27 mars, 2010, fq. 1. Sipas këtij Raporti, kënaqshmëria me punën e Kuvendit ka rënë për rreth 13% që nga shtatori 2009

²¹ Naim RRUSTEMI – Jeta në Kosovë: Debati Parlamentar dhe Masat Anti-Korrupsion, RTK

²² Ramadan AVDIAJ - Jeta në Kosovë: Debati Parlamentar dhe Masat Anti-Korrupsion, RTK

edhe në institucione të ndryshme publike.²³ Kështu që Kuvendi i Kosovës, në vend që të miratojë ligje që rregullojnë përfitimet e tyre personale (siç është pensioni suplementar), duhet të angazhohet seriozisht për miratimin ligjeve tjera më rëndësi përmbajtjesore, siç janë: Ligji për Financimin e Partive Politike, Ligji Anti-mafia dhe Ligji për Shpëlarjen e Parave.

SISTEMI GJYQËSOR

Njëra ndër pushtetet më të rëndësishme, të cilido sistem politik, është edhe pushteti gjyqësor. Ky pushtet, nëse është i paanshëm dhe i pavarur, atëherë apriori siguron dhe kufizon çdo lloj mundësie për shpërdorim të parasë publike apo të pozitës zyrtare. Në këtë kontekst, njëra nga arsytet pse korrupsioni dhe krimi i organizuar është shtrirë gjithandej institucioneve, është edhe zhytja e vet sistemit gjyqësor në korrupsion dhe rënia e tij në grackën e presioneve dhe interferencave politike. Një konstatim të tillë e konfirmon edhe Raporti i fundit i EULEX-it, i cili thekson se sistemi i drejtësisë në Kosovës ende tregon shenja të dobësisë. Më tutje thuhet se interferencat në nivele të ndryshme dhe në forma të llojlojta janë evidentuar.²⁴ Gjyqësori i Kosovës vazhdon të jetë institucioni që qytetarët janë më së paku të kënaqur. Edhe Raporti i Paralajmërimit të Hershëm ka regjistruar një rënie prej 10% që shënon nivelin më të ulët të regjistruar ndonjëherë.²⁵ Prandaj, meqë demokracitë assesi nuk mund të funksionojnë pa sistemin gjyqësor, ngase garanton dhe kontrollon pushtetet tjera, atëherë

edhe Kosova duhet të ndërmarrë hapa të shpejtë dhe seriozë për reformimin e thellë të saj.

PROKURORIA E KOSOVËS, e cila vepron në kuadër të sistemit gjyqësor, nuk ka shënuar ndonjë aktivitet të veçantë gjatë muajit maj në luftën kundër korrupsionit. Kjo është duke ngjarë ngase sistemi prokuroria e ai gjyqësor në Kosovë është duke u këndellur dhe aftësuar për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.²⁶ Në gazeta Kosova Sot është raportuar se dosjet e korrupsionit 'mrizojnë' në sirtarë. Sipas të gjetura e saj, vetëm në vitin 2009 kanë mbetur pa u shqyrtuar mbi 10.000 kallëzime penale, të cilat janë lënë në pluhurin e "harresës" nga prokurorët, duke përfshirë edhe ato të korrupsionit.²⁷ Ajo që vlen të nënvizohet në këtë Raport është procesi i riemërimit të 76 gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Kosovës. Ky proces i riemërimit ka lënë anash gjysmën e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo do të ndikojë që gjyqtarët dhe prokurorët e riemëruar do të bëhen më të përgjegjshëm dhe llogaridhënës ndaj funksioneve të tyre. Përveç këtij procesi të rëndësishëm, Prokuroria ka nënshkruar edhe marrëveshjen me Agjensionin Kundër Korrupsionit dhe realizimin e disa takimeve të ndryshme që ndërlidhen me fuqizimin e këtij institucioni për ta luftuar mirëfilli korrupsionin dhe krimin e organizuar.

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, i cili siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale dhe të paanshme, nuk ka shënuar ndonjë aktivitet të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit. Sipas Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të

²³Ahmet ISUFI: Zbardhja e korrupsionit me hetime Parlamentare, Koha Ditore, 13 qershor, 2010, fq. 2

²⁴ Program Raporti 2010: Ndërtimi i Përbashkët i Ndryshimit të Qëndrueshëm, EULEX, qershor 2010, fq. 9

²⁵ Raporti i Paralajmërimit të Hershëm, UNDP Kosovë, 27 mars, 2010, fq. 2

²⁶Prokurorët kosovarë, sipas Kryeprokurorit KABASHI, kanë guxim të urdhërojnë ndjekjen penale dhe arrestimin e kujtdo qoftë. Zotime po kaq të forta ka japë edhe kryetari i Gjykatës Supreme, Fejzullah HASANI, sipas të cilit ekziston guximi dhe kapacitetet. Më gjerësisht shih Koha Ditore, 20 qershor, 2010, fq. 1-2

²⁷ K. GASHI: Dosjet e korrupsionit 'mrizojnë' në sirtar, Kosova Sot, 6 qershor, 2010, fq. 2

MONITORUESI I KORRUPSIONIT

Kosovës, Enver Peci, asnjëherë nuk ka pasur ndërhyrje direkte në vendimmarrje të gjyqësorit, mirëpo varësia ekonomike e buxhetore ndikon në varësinë e gjyqtarëve.²⁸ Kryesuesi Enver Peci ka pranuar po ashtu se nuk është i kënaqur me një praktikë, e cila është instaluar në KGJK dhe që ka të bëjë me miratimin e dorëheqjeve të gjyqtarëve të cilët kanë kryer shkelje disiplinore dhe të cilët për t'i ikur kësaj përgjegjësie japin dorëheqje. Sipas tij duhet të bëhet shqiptimi i masave disiplinore për të gjithë gjyqtarët e tillë, në mënyrë që t'u pamundësohet jetëgjatësia e tyre në institucionet publike. Ndërkaq Agjensioni Kundër Korrupsionit është duke hulumtuar edhe rastin e mundësisë së konfliktit të interesit në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Përbërja e KGJK-së, sipas AKK-së, është në konflikt të pastër interesi dhe është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Sipas nenit 108 KGJK-ja përbëhet nga 13 anëtarë: 5 gjyqtarë do të jenë të zgjedhur, 4 nga deputetët e Kuvendit, të paktën 2 nga 4 anëtarët duhet të jenë gjyqtarë dhe 1 duhet të jetë anëtar i Odës së Avokatëve. Ndërkaq në përbërjen aktuale punon më shumë sesa një avokat, gjë që paraqet konflikt të pastër interesi.²⁹ Gjatë Raportit të II (që përfshinë muajt prill, maj dhe qershor) shihet qartazi se KGJK ka arritur t'i zgjidhë vetëm 13 lëndë që kanë të bëjnë me shpërdorim të detyrës zyrtare, marrje të ryshfetit dhe dhënie të ryshfetit, ndërkaq 144 kanë mbetur të pazgjidhura.

²⁸ Enver PEÇI: Reformat e vonuara, shpëtimi i gjyqësorit, Koha Ditore, 20 qershor, 2010, fq. 1-2

²⁹ K. GASHI: Nisin hetimet për konfliktin e interesit në KGJK, Kosova Sot, 14 qershor, 2010, fq. 9

Neni	Përshkrimi i llojit të veprave	Lëndë të pazgjidhur në fillim të periudhës raportuese	Lëndë të pranuar në punë	Gjithsej lëndë në punë	Gjithsej lëndë të zgjidhura	Lëndë të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese
339	Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit	110	9	119	10	109
343	Marrja e ryshfetit	22	3	25	1	24
344	Dhënia e ryshfetit	11	2	13	2	11
Totali sipas linjave		143	14	157	13	144

Lëndët Penale të trashëguara, të pranuar dhe të zgjidhura sipas kapitullit nga Gjykatat Komunale në Republikën e Kosovës:

Tabela 1: (KGJK) Numri i rasteve gjatë periudhës prill-maj-qershor, 2010

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT

Angazhimet kryesore të Agjencisë Kundër Korrupsionit kanë qenë në shumë drejtime. Në fillim të qershorit ka përmbyllur suksesshëm procesin e deklarimit të pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë publikë. Numri i zyrtarëve të cilët kanë qenë të obliguar ta deklarojnë pasurinë e tyre në vitin 2010 ka qenë 1560, ndërkaq vetëm 70 prej tyre nuk e kanë kryer këtë obligim, 4 nuk e plotësuar aplikacionin në formën e kërkuar dhe 1 zyrtar tjetër

MONITORUESI I KORRUPSIONIT

ka kërkuar që t'i mos publikohet pasuria e tij.³⁰ AKK-ja është duke e verifikuar pasurinë e zyrtarëve të cilët mendohen se pasuria e tyre është e stisur dhe tashmë 20 prej tyre janë duke u verifikuar.³¹ AKK-ja ka vazhduar ritmin e nënshkrimit të memorandumeve me institucionet tjera, të cilat do të ndihmojnë në bashkërendimin e aktiviteteve institucionale në luftë kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Gjatë muajit qershor është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit me Prokurorinë e Shtetit, me Administratën Tatimore të Kosovës dhe me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm. Sipas këtyre memorandumeve, palët do t'i ofrojnë njëra tjetrës informata për çështjet që janë me interes të dyanshëm. Do të ketë po ashtu efekte të drejtpërdrejta në prodhimin e rezultateve më të theksuara nga ana e AKK-së dhe do të krijojë hapësirë më të madhe për bashkëpunim ndër-institucionalë, ngase lufta ndaj korrupsionit kërkon dhe presupozon një bashkërendim të aktiviteteve të të gjitha institucioneve të cilat janë përgjegjëse për ta luftuar korrupsionin. AKK-ja edhe gjatë muajit qershor ka vazhduar pranimin e informacioneve për afëra të ndryshme korruptive. Sipas shefit të AKK-së, Hasan Preteni, numri i raportimeve nga ana e zyrtarëve për rastet e tilla korruptive është rritur dukshëm. Kjo demonstroi se është ngritur vetëdija e zyrtarëve për të zbuluar aferat korruptive që përfshihen zyrtarë të ndryshëm.

DOGANAT

Statistikat e Anti-korrupsionit të Doganave të Kosovës tregojnë se është shqiptuar vetëm një masë

³⁰ Në lidhje me këtë proces të publikimit të pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë publikë, ju lutem vizitoni ëbfaqen e AKK-së - <http://ëëë.akk-ks.org>

³¹ Një pohim të tillë e ka bërë më dije shefi i AKK-së, Hasan Preteni, në Tryezën "Lufta ndaj Korrupsionit: Progresi dhe Koordinimi Ndër-institucional", organizuar nga Lëvizja FOL, 24 qershor, 2010.

disiplinore gjatë qershorit. Kjo masë ka qenë vetëm vërejtje me gojë – për shkak të sjelljes jo profesionale. Edhe në Sektorin e Standardeve Profesionale janë iniciuar 4 raste: 3 raste janë iniciuar për dyshim për korrupsion (keqpërdorim të pozitës zyrtare) dhe 1 rast për mos-deklarim të pasurisë.

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka publikuar Raportin e saj Vjetor për të gjitha ministritë, komunat, ndërmarrjet publike, agjensionet dhe institucionet tjera. Sipas këtyre Raportëve rezultoi edhe më tutje nevoja për të ndërmarrë hapa në përmirësimin e menaxhimit më të drejtë të financave publike dhe ngritjen e performancës së institucioneve përkatëse. Megjithatë, Raporti ka evidentuar një sërë parregullsish: mos-shpalosja komplete e të ardhurave financiare, marrja e pagave pa mbulesë, mos-futja e të ardhurave publike në pasqyrat financiare, gabime në përzgjedhjen e ofertuesve, gabime në kontrata dhe lëshime në dhënien e tenderëve dhe menaxhimin e tyre. ZAP-i ka nënshkruar edhe Memorandumin e Mirëkuptimit me AKK-në, e cila do të mundësojë shkëmbimin e informacioneve relevante që ndërlidhen me afëra korruptive.³²

POLICIA E KOSOVËS

Policia e Kosovës vazhdon edhe më tutje të perceptohet nga qytetarët e Kosovës si institucioni më i besueshëm dhe më pak i korruptuar. Rreth 76% e qytetarëve (përkundrajt 72% në shtator 2009) e të intervistuarve janë të kënaqur me punën e Policisë së Kosovës dhe vetëm një përqindje e vogël mendojnë se korrupsioni është i pranishëm në Policinë e Shtetit. Edhe Raporti i fundit i EULEX-it tregon për një shkallë progresioni të Policisë së

³² Më gjerësisht shih ëbfaqen zyrtare të Auditorit të Përgjithshëm: <http://ëëë.ks.gov.net/oag>

MONITORUESI I KORRUPSIONIT

Kosovës në relacion me kundërvënien ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar³³. Ushtruesi i detyrës së drejtorit të Policisë së Kosovës, Behar Selimi, ka paralajmëruar se do të ketë gradime për zyrtarët policorë që tregojnë rezultate të kënaqshme në punën e tyre, ndërsa do të ketë edhe degradime

për ata që tregojnë ngecje në punën e tyre.³⁴ Për të arritur rezultate

produktive, zyrtarët e Policisë së Kosovës kanë shpallur vendin e lirë të punës së për Drejtorinë e Hetimit të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit. Kjo është rrjedhojë e ristrukturimit që

është duke ngjarë brenda institucionit të Policisë dhe synohet që të prodhohen të arritura në kontekstin e performansës së PK-së. Në fillim të qershorit Policia e Kosovës ka arrestuar në Ferizaj dhe Prishtinë tre persona të dyshuar, njëri prej tyre zyrtar i Policisë. Në një aksion tjetër të realizuar janë arrestuar edhe tre persona tjerë për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Dy të arrestuarit kanë qenë administratori i Gjykatës Komunale në Ferizaj, referenti i po kësaj gjykate dhe zyrtari i parë i institucionit mikro-financiar “Kreditimi Rural i Kosovës”.³⁵ Në një takim që ka realizuar stafi i Lëvizjes FOL me ushtruesin e detyrës së drejtorit të Policisë së Kosovës, Behar Selimi, është premtuar nga ana e tij që Policia e

Kosovës do të jetë plotësisht transparente dhe e hapur për shoqërinë civile, në mënyrë që të vizatohet dhe pasqyrohet puna e këtij institucioni karshi korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Llojet e Veprave	Nën Hetime	Të dërguara në Prokurori me kryerës të njohur	Të dërguara në Prokurori me kryerës të panjohur	Rastet e dërguara me Raport të Prokurori	Numri i të arrestuarve
Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit	44	41		64	17
Përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës	1	3		1	1
Mashtrimi në detyrë				1	
Përdorimi i paautorizuar i pasurisë					
Marrja e ryshfetit	6	4		2	
Dhënia e ryshfetit		1			1

Përmbledhje e aktiviteteve të Drejtorisë për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit – Gjatë Periudhës Janar-Qershor 2010

Tabela 1: (PK) Numri i rasteve gjatë periudhës janar-qershor, 2010

Sipas statistikave të dorëzuara nga PK-ja, shihet sheshazi se përgjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, DHKEK-ku ka arritur t'i realizojë me sukses shumë aktivitete dhe objektiva të cilat i ka paraparë në planin zhvillimor vjetor të vitit 2010, si dhe aktivitetet të cilat që nuk janë të parapara me këtë plan. Në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve, nga fushë veprimtaria e DHKEK, synimet dhe objektivat strategjike kanë qenë të përqendruara në parandalimin, luftimin dhe hetimin e krimit dhe korrupsionit. Ndërkaq zëdhënësja e EULEX-it, Kristina Herodes, ka pohuar që policët dhe prokurorët e EULEX-it si dhe policët vendorë janë duke hetuar rastet e korrupsionit dhe kurdo që do të ketë dëshmi të mjaftueshme do të procedohen

³³ Program Raporti 2010: Ndërtimi i Përbashkët i Ndryshimit të Qëndrueshëm, EULEX, qershor 2010, fq. 13-23

³⁴ Behar SELIMI: Spastrime në Polici, Kosova Sot, 21 qershor 2010, fq. 9

³⁵ K. GASHI: Keqpërdorën detyrën, tre të arrestuar në Pejë e Ferizaj, Kosova Sot, 10 qershor, 2010, fq. 13

rastet përmes gjykatave.

RAPORTET NDERKOMBËTARE/TË JASHTME

Të gjitha Vlerësimet dhe Raportet ndërkombëtare/të jashtme, që vizatojnë dhe pasqyrojnë zhvillimet e gjithmbarshme në Kosovë, shpërfaqin një nivel të lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Dhe, më pastaj, institucionet e shumta ndërkombëtare, mbi bazën e këtyre Raporteve, i artikulojnë dhe shprehin shqetësimet e tyre për shkallën e lartë të shtrirjes së korrupsionit, i cili, në fakt, është duke i ngulfatur dhe kërcënuar seriozisht proceset demokratizuese në vend. Prandaj, Kosova, jo rrallëherë, është renditur përkrah “shteteve të dështuara” – me nivel të jashtëzakonshëm të zhvatjes së parasë publike dhe abuzimit me autoritetin publik. Edhe Raportet e fundit të publikuara nga Freedom House, Raporti i Paralajmërimit të Hershëm i UNDP-së, Raporti i Iniciativës Kosovare për Stabilitet³⁶ dhe ai EULEX-it shquhen për zërin tejet kritik dhe të drejtpërdrejt për autoritetet vendore të cilat janë të thirrura për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, por, për fat të mjerë, vet janë të zhytura dhe të përfshira në afëra korruptive dhe krim të organizuar. Derisa Raporti i Freedom House është një hulumtim cilësor që trajton funksionimin e sistemit politik në tërësi, Raporti i Paralajmërimit të Hershëm është një hulumtim sasior, i cili matë perceptimin qytetar në relacion me institucionet gjegjëse. Prandaj, institucionet tona, por edhe shoqëria në tërësi, duhet të angazhohen seriozisht për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, në mënyrë që Raportet e ardhshme, qoftë vendore, qoftë ndërkombëtare, ta pasqyrojnë Kosovën me një panoramë optimiste dhe shpresëdhënëse, e asses

³⁶ IKS është themeluar në vitin 2004. Është think-tank i pavarur dhe jo-profitabil. Përqendrohet në hulumtime empirike dhe analiza të zhvillimeve socio-ekonomike në Kosovë. Përbëhet nga analistë dhe praktikantë kosovarë dhe ndërkombëtarë

përmes një tablo tepër të errët dhe të zymtë. Natyrisht, kjo nuk një rrugë e lehtë dhe e shkurtër. Përkundrazi, është përplot vështirësi. Por, përball nevojave dhe kërkesave të mëdha të shoqërisë, këto pengesa duhet tejkaluar dhe, për të mirën e përgjithshme, duhet sakrifikuar ngulmimin dhe prirjen për ta shpërdoruar pushtetin dhe paranë publike.

RAPORTET NGA SHOQËRIA CIVILE

Edhe shoqëria civile në Kosovë, e cila pranohet gjerësisht se është esenciale për proceset demokratizuese në vendin tonë, ka ndërmarrë një sërë aktivitete në luftë kundër korrupsionit dhe praktikave tjera korruptive. Qëllimi i aktiviteteve të shoqërisë civile, përkatësisht e organizatave jo-qeveritare, ka qenë denoncimi i praktikave korruptive dhe deformuese të keq-qeverisjes. Në këtë kontekst, gjatë muajit qershor janë shënuar dy aktivitete të ndryshme nga dy organizata të ndryshme.

LËVIZJA FOL - Gjatë këtij muaji ka organizuar një tryezë të rrumbullakët: “Lufta ndaj Korrupsionit: Progresi dhe Koordinimi Ndër-institucional”, në të cilën është prezantuar edhe një Raport Përmbledhës katër mujor. Në këtë Tryezë është diskutuar për gjendjen momentale të bashkëpunimit ndër-institucional dhe progresin në luftën kundër korrupsionit. Sipas panelistëve të ftuar është shprehur domosdoshmëria e thellimit dhe rritjes së këtij bashkëpunimit. Po ashtu është shprehur edhe nevoja dhe domosdoshmëria për ta thelluar dhe rritur këtë koordinim, pastaj për ta plotësuar kornizën ligjore kundër-korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe vetëdijësimin e qytetarëve për të qenë pjesë e këtij procesi jetik për vendin tonë. Po në këtë muaj është publikuar edhe Indeksi i Transparencës së Institucioneve të Kosovës. Me këtë Indeks është synuar vënien në sipërfaqe e faktit sesa të hapura janë institucionet tona karshi opinionit publik. Sipas këtij Indeksi, Doganat e Kosovës dhe

MONITORUESI I KORRUPSIONIT

Agjensioni Kundër Korrupsionit janë pishtarët e transparencës.

INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS - Edhe KDI ka publikuar një Raport në muajin qershor në lidhje me Ligjin për Deklarimin, Kontrollin dhe Prejardhjen e Pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë. Ky hulumtim ka qenë njëkohësisht edhe analizë krahasuese me sistemet e tjera politike: Shqipërinë, Kroacinë dhe Maqedoninë. Sipas këtij publikimi Shqipëria është më e avancuar në disa aspekte. Së pari, ligji i Shqipërisë parashih sanksione për ata që nuk i respektojnë ligjin, duke ndaluar kështu ushtrimin e funksioneve publike, ndërkaq ligji në Kosovë sanksionon zyrtarët në fjalë vetëm në vlerë monetare. Dhe së dyti rregullon procedurën e verifikimit të pasurisë, gjë që me Ligjin në Kosovë nuk ngjanë një çështje e tillë. Përveç këtyre aktiviteteve KDI ka publikuar edhe Raportin e saj të muajit maj në lidhje me punën dhe funksionimin e Kuvendit të Kosovës. Në këtë publikim është evidentuar puna dhe mos-puna e Kuvendit. Papërgjegjësia e deputetëve për të marrë pjesë në seancat plenare dhe në komisionet parlamentare ka qenë një gjetje tjetër në Kuvendin e Kosovës.

FALËNDERIME

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga USAID përmes Programit për Fuqizimin e Shoqërisë Civile i implementuar nga ISC – Instituti për Komunitete të Qëndrueshme (Institute for Sustainable Communities). Ky Raport, po ashtu, është produkt dhe rezultat i kontributit të një ekipi të përkushtuar, si nga stafi i lëvizjes FOL, por edhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL mbi Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë kundër Korrupsionit janë të publikuara në këtë faqe: ëëë.monikorr.org

RRETH LËVIZJES “FOL”

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale, si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

KONTAKTO:

Andrea Gropa 29, 100000 Prishtinë,

Republika e Kosovës

Mob: +377 (0) 44 131 542

Ueb: levizjafol.org

E-mail: info@levizjafol.org